

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE - NATYRORE
DEPARTAMENTI BIOLOGJI
PROGRAMI EKOLOGJI DHE MBROJTJE E MJEDISIT



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

**Vlerësimi i veçorive kryesore ekologjike dhe presioneve mjedisore në
lumin Mirusha**

Mentori:

Prof. Dr. Halil IBRAHIMI

Kandidatja:

Arbnore THAÇI

Prishtinë, 2024

Abstrakt

Monumenti i natyrës “Ujëvarat e Mirushës” është një ndër zonat më të bukura dhe më interesante të natyrës së Kosovës, e cila shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, në territorin e komunave Klinë, Malishevë dhe Rahovec. Në këtë Monument lumi Mirusha në pjesën e poshtme të rrjedhës së tij kalon nëpër një grykë e cila njihet si kanjoni i lumit Mirushë. Lumit Mirusha shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, gjerësisht në anën lindore të Rrafshit të Dukagjinit. Është degë e majtë e Drinit të Bardhë dhe përfshinë pjesën më të madhe të trevës së Llapushës, i cili është kryesisht rajon kodrinor - malor.

Metodologjia e vlerësimit të biodiversitetit në lumin Mirusha është bërë sipas metodave standarde të mostrimit dhe rishikimit të literaturës.

Mostrimi i makroinvertebrorëve:

Mostrat janë mbedhur më anë të rrjetës në formë të shkronjës “D” (30 cm x 30 cm) me madhësinë e vrimave prej 500 µm. Marrja e mostrave është bërë në atë mënyrë që rrjeta është përforcuar për substrati të lumit e pastaj substrati është trazuar më një lopatëz metalike, gurët janë shpërlarë me brushë para rrjetës, kurse rëra dhe lymi që janë trazuar kanë hyrë në rrjetë.

Materiali faunistik është mbledhur në një shtrirje prej 50 deri 100 m në drejtim poshtë - lartë të rrjedhës së lumit. Pastaj mostrat e mbledhura janë zbrazur nga rrjeta në një enë plastike me fund të bardhë dhe nga aty makroinvertebrorët me anë të pincetës janë vendosur në gota qelqi dhe janë konservuar në alkool 96 %. Brenda secilës shishe janë vendosur letrat e Paust-it me të dhënat për datën dhe vendin ku janë mbledhur mostrat. Ndarja dhe determinimi është bërë në laborator të zoologjisë ku edhe është deponuar dhe determinohet materiali i konservuar më anë të stereomikroskopit binokular duke përdorur çelësat taksonomik për determinimin e grupeve të caktuara të shtazëve.

Mbledhja e adultëve të insekteve ujore:

Mbledhja e Trichopterave është bërë me kurtha me dritë (UV) të cilat kanë qëndruar tërë natën në lokalitetet përkatëse pastaj në mëngjesin e ardhshëm është bërë mbledhja e insekteve të grumbulluara. Në këtë rast, një enë e bardhë plastike e mbushur deri në gjysmë me ujë është

vendosur në vendin për mostrim. Mbi enë është vendosur burimi i dritës ultravjollce, kurse në ujin e vendosur në enë janë hedhur disa kokrra detergjent me qëllim që insektet të cilat bien në ujë të tërhequra nga drita të mos mund të dalin më. Të nesërmen në mëngjes me anë të pincetave kemi mbledhur insektet e rëna në enë dhe i kemi vendosur në shishe nga plastika me alkool 96 %. Brenda secilës shishe është vendosur etiketa me të dhënat për datën dhe vendin ku janë mbledhur mostrat.

Për realizimin e këtij hulumtimi kemi përzgjedhur gjithsej 10 lokacione studimi, mbledhja e mostrave është bërë gjatë stinës së pranverës, verës dhe vjeshtës të vitit 2024. Gjatë hulumtimit në terren në rrjedhjen e lumit Mirusha, ne dokumentuam gjithsej 34 lloje insektesh të rendit Trichoptera të cilat i takojnë 11 familjeve. Gjatë këtij hulumtimi u identifikua lloji endemik *Rhyacophilla macedonica*, dhe nëntë lloje në kategorinë të rrallë në Kosovë; *Agapetus laniger*, *Helicopsyche bacescui*, *Ithytrichia lamellaris*, *Stractobiella risi*, *Tinodes jannsensi*, *Halesus tessellatus*, *Mesophylax aspersus*, *Lepidostoma hirtum*, *Anabolia furcata*, dhe në bazë të kësaj mbrojtja e lumit Mirusha është thelbësore për ruajtjen e biodiversitetit.

Në vitin 2024 është bërë një databazë e llojeve në të cilën janë të dokumentuara 181 lloje të Trichopterave në Kosovë. Bazuar në këtë numër, 34 llojet që janë konstatuar në hulumtimin tim në rrjedhjen e lumit Mirusha paraqesin 0.18 % të numrit të llojeve në Kosovë, pra mund të themi se është numër i vogël që tregon se Trichopterat nuk janë shumë të përhapura në rrjedhjen e lumit Mirusha.

Fjalët kyçe: insekte, ekosisteme ujore, lloje endemike, lloje të rralla.